



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa:Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë

Tel.+355 4 2226288, www.ama.gov.al

Nr. _____Prot

Tiranë, më _____.____.2015

FTESË PËR NEGOCIATË

Drejtuar: Organeve të masmedias, Agjensive të Specializuara (ndërkombëtar/e, kombëtar/e, vendor/e)

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike”, “Plani i Veprimt, Për ndjekjen e zbatimit të Strategjisë së Kalimit të Plotë në Transmetimet Numerike”, Urdhri nr. 77, datë 02.06.2009 “Për ngritjen e komitetit ad hoc për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në digjitale”, pika d e nenit 19 të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, pika b e nenit 7 e ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin, e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, kërkon të realizojë procedurën për blerje, zhvillim, prodhim të tre spoteve informuese, transmetimin e tyre në web-site (portale online) dhe shërbim design për të gjithë fushatën, me objekt: **“Fushatën e informimit të publikut për procedurën e kalimit në transmetimet numerike”**.

OBJEKTI I SPOTEVE

Objekti i spoteve do të jetë: **“Fushata e informimit të publikut për procedurën e kalimit në transmetimet numerike”**

Nevoja për kryerjen e programit: Nevoja e kryerjes së fushatës së Informimit të Publikut për Procedurën e Kalimit në Transmetimet Numerike vjen në zbatim të një prej detyrimeve që rrjedhin nga Strategjia e Kalimit në Transmetimet Numerike dhe nevojës imediate për informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut shqiptar në lidhje me digjitalizimin. AMA, nëpërmjet ndërmarrjes së një fushate gjithëpërfshirëse komunikimi me target grupet e ndryshme të popullsisë, synon informimin, ndërgjegjësimin dhe njohjen e publikut me risitë e digjitalizimit.

Fondi limit i përcaktuar: Fondi limit i procedurës së prokurimit është me vlerën 10,583,333 (dhjetëmilione pesëqindetë dhjetë tetë mijë tetëqindetë dhjetë) lekë pa TVSH.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa:Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë

Tel.+355 4 2226288, www.ama.gov.al

Numri i Reklamave/Spoteve: Kërkohet blerje, zhvillim, prodhim i 3 (tre) reklamave/spoteve, (audio dhe video) minutazhi i të cilave do të përcaktohet në mbështetje të përmbajtjes së secilës reklamë/spot (ref. Termat e Referencës).

Shërbim Design: Konceptimi dhe përgatitja e të gjithë fushatës informuese ku përfshihen imazhi kryesor i fushatës me sloganin përkatës, përgatitja e webanerave në formate të përshtatshme për tu publikuar në portale të ndryshme online.

Shpeshtësia dhe Periudha e shfaqjes së spoteve: Minutazhi i spoteve duhet të jetë jo më pak se 1 min dhe jo më shumë se 3 min. Spotet do të jenë 24 orë në 24 të shfaqura në web-site dhe do ti përmbahen përmbajtjes së përcaktuar nga AMA (si më poshtë), që do ti shërbejnë të njëjtës ide të fushatës.

Periudha e shfaqjes së tyre do të jetë 3 muaj dhe do fillojë nga data e marrjes së vendimit nga AMA.

Spotet duhet të jenë të përshtatshëm edhe për personat me aftësi të kufizuar, në shikim dhe dëgjim, pra të kenë të integruar shpjegimin e nevojshëm për këtë kategori.

Zhvillimi dhe prodhimi i tre spoteve të jetë i përshtatshëm edhe për transmetimin e tyre në median audiovizive.

Transmetimi në web-site (portale online): Tre spotet që do të realizohen do të transmetohen në jo më pak se 7 web-site (portale online) shqiptare më të mëdha dhe të klikuara, në profilin informativ, për një periudhë kohore prej 3 muajsh.

Karakteristikat e web-site (portale online): Web-sitet (portalet online) shqiptare, duhet të kenë shikueshmëri të lartë, të kenë profil informativ, të kenë format, design dhe karakteristika teknike të mirëdefinuara.

Spotet do të pozicionohen në pjesën kryesore ballinë të website, në pozicion lehtësisht të dukshëm në momentin e hapjes së tij.

Audienca e Targetuar: Publiku shqipfolës i interesuar në këtë proces.

Kohëzgjatja e fushatës: 3 muaj.

Periudha e realizimit të spoteve: 15 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës ose knfirmimit zyrtar nga ana e AMA-s me operatorin ekonomik që do të shpallet fitues.

Oferta për vazhdimësinë e procedurës: Ofertat duhet të vinë të gjitha në një ditë të vetme, të mbyllura me zarf, të shënuara me adresë dhe emërtimin e subjektit, në rast të kundërt ata do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel.+355 4 2226288, www.ama.gov.al

Data përfundimtare për paraqitjen e ofertës dhe dokumentacionit nga organet e medias/ agjencitë e specializuara është deri më datë **20.07.2015, në orën 12:00**, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.

KËRKESA SPECIFIKE / SPECIFIKIMET TEKNIKE:

- PËRMBAJTJA E SPOTEVE

Përgatitja e 3 Spoteve dhe shërbim design për fushatën e informimit të publikut për procedurën e kalimit në transmetimet numerike.

Termat e Referencës:

Qëllimi i këtyre spoteve do të jetë informimi i publikut për procedurën e kalimit në transmetimet numerike.

➤ **Spoti i parë do të përmbajë informacionin si mëposhtë:**

Për tekstin e spotit:

Digjitalizimi është epoka e re e transmetimeve televizive në Europë. tashmë, edhe në Shqipëri. Transmetimet e sotme analoge do të ndërpriten dhe zhvillimet e reja teknologjike, përmes ekranit të televizorit, do të jenë të pranishme në shtëpitë tuaja.

Me transmetimet digjitale përfitimet e konsumatorit (publikut) janë të drejtpërdrejta, të dukshme, të prekshme: Teknika digjitale do të sjellë për ju:

- **Më shumë kanale të disponueshëm:**

Në transmetimin analog një frekuencë përçonte një program të vetëm ndërsa në transmetimin digjital një frekuencë e vetme përçon deri në tetë programe. Kjo do të thotë më shumë mundësi e më shumë zgjedhje, më shumë informacion, më shumë kulturë e argëtim, më shumë pluralizëm dhe edukim përmes ekranit të televizorit tuaj.

- **Më shumë shërbime dhe aplikime:** Do të ketë shumë shërbime dhe aplikime ndërvepruese të mbështetura në teknologjitë e fundit. Platformat e reja i lejojnë shikuesve të shohin programin e dëshiruar në çdo kohë.

- **Ndërveprim me televizorin drejtpërdrejt:**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel.+355 4 2226288, www.ama.gov.al

Ju mund të ndërveproni me programet përmes telekomandës, me opsione praktike, të dobishme e të shumëllojshme.

- **Më pak ndotje elektromagnetike:**

Televizioni digjital kërkon fuqi transmetimi më të ulët se televizioni analog.

Për figurën e spotit:

Pamje krahasuese të studiove aktuale dhe studiove digjitale të transmetimit, të kamerave digjitale dhe HD, të lidhjeve, moduleve, duke theksuar përparësitë, etj.

Krahasime të figurave në transmetim analog me ato digjitale; (mundësisht të njëjtës pamje)

Ilustrim i ndërveprimit përmes telekomandës; (opsionet, shembuj)

Pamje e krahasim të dekoderave aktuale dhe të atyre universalë ose moduleve të përfshirë në aparatin marrës.

Synime të spotit

1. *Të tërheqë vëmendjen mbi një zhvillim të ri mediatik e shoqëror;*
2. *Të theksojë rëndësinë e procesit të digjitalizimit;*
3. *Të shtojë shikueshmërinë e spoteve të kësaj natyre;*
4. *Të lehtësojë aksesin e publikut në proces;*
5. *Të informojë publikun për veçoritë dhe përfitimet prej digjitalizimit.*

➤ **Spoti i dytë do të përmbajë informacionin si më poshtë:**

Tashmë jeni njohur me procesin e digjitalizimit. Me siguri keni shumë pikëpyetje.

Cilat do të jenë ndryshimet e kalimit në transmetimin digjital?

A mund ta realizoni ju vetë nga shtëpia juaj, apo duhet ti drejtoheni teknikut? Sado pak të dini për tekniken digjitale, ju lehtësisht mund të kryeni marrjen e transmetimeve në formatin e ri digjital.

Për këtë mjafton të keni një aparat marrës (dekoder), i cili mund të jetë pajisje më vete ose e përfshirë në televizorin tuaj.

Televizorët e gjeneratës së vjetër "Tregohet në pamje një televizor CTR (tub katodik)" nuk e kanë të përfshirë dekoderin.

Lidhja me dekoderin e jashtëm kryhet kështu "Tregohet me pamje lidhja me antenën dhe me SCART"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel.+355 4 2226288, www.ama.gov.al

Në televizorët e gjeneratës së re "Tregohet në pamje një televizor LCD ose LED" te cilët nuk e kanë të përfshirë dekoderin lidhja mund të kryhet përveç se si në shembullin që porsa shikuat, edhe me kabull HDMI. "tregohet me pamje lidhja me antenën dhe me kabull HDMI". Në televizorët e gjeneratës së re "Tregohet në pamje një televizor LCD ose LED" te cilët e kanë të përfshirë dekoderin "Tregohen pamjet e panelit të TV ku gjendet ndërfaqja e CAM (Conditional Access Module)", për të parë transmetimet digjitale mjafton vetëm lidhja e televizorit me antenë.

➤ **Spoti i tretë do të përmbajë informacionin si më poshtë:**

Spoti do të përmbajë informacion të hollësishëm mbi parametrat që duhet të kenë dekoderat e rinj. Gjithashtu spoti do të informojë mbi skemat që do të përdoren për shpërndarjen e tyre tek familjet në nevojë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

- PROCESI I KRIJIMIT DHE PUBLIKIMIT

Operatori që do të marrë përsipër këtë fushatë, duhet të fokusohet në elementet e mëposhtëm:

- Duhet të krijojë prodhojë dhe transmetojë 3 spote në website/portale online.
- Spotet do të jenë 24 orë në 24 të shfaqura në web-site (portale online), në formën e reklamës, pa ndërprerje, në mënyrë të alternuar me njeri tjetrin dhe me përmbajtje të përcaktuar nga AMA, që do të shërbejnë të njëjtës ide të fushatës.
- Imazhet që do të përdoren duhet të jenë të përshtatshëm dhe të kuptueshëm nga publiku i gjerë. Me qëllim që mesazhet e transmetuara nga video informative të jenë lehtësisht të kuptueshme, subjekti i kontraktuar do të sigurohet që gjuha e përdorur në video është gjuha shqip zyrtare. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë që mesazhet e transmetuara përmbajnë terma teknikë, të cilat mund të jenë të vështira për t'u kuptuar nga publiku, subjekti fitues duhet të sigurojë që gjuha (terminologjia) e përdorur në skriptin e videos të jetë e qartë dhe e kuptueshme. Subjekti i kontraktuar duhet të sugjerojë, nëse është rasti, terminologjinë e duhur, eliminimin e fjalëve apo shkurtimeve të paqarta për publikun si dhe shkurtimin e fjalive të gjata.
- Gjithashtu ofertuesi duhet të paraqesë një projekt – ide koncize të realizimit të spotit.
- Spotet duhet të jenë të përshtatshme për personat me nevoja të veçanta shqisore, pra të realizohet për tu kuptuar nga kjo kategori.
- Operatori ekonomik gjatë realizimit të spotit do të jetë në konsultim të vazhdueshëm me ekipin mbikqyrës të fushatës të caktuar nga AMA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa:Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë

Tel.+355 4 2226288, www.ama.gov.al

- Spoti duhet të paraqitet edhe në formatin DVD.
- Spoti të transmetohet me figurë dhe me zë.
- Zhvillimi dhe prodhimi i tre spoteve të jetë i përshtatshëm edhe për transmetimin e tyre në median audiovizive.

- LANÇIMI I SPOTEVE NË WEBSITE/PORTALE

- Fushata do të transmetohet përmes publikimit të spoteve në website/portale online 24 orë në 24.
- Web-site (portalet online) shqiptare, duhet të kenë shikueshmëri të lartë, të kenë profil informative, të kenë format, design dhe karakteristika teknike të mirëdefinuara.
- Spotet të pozicionohen në pjesën kryesore ballinë të website, në vend kryesor, lehtësisht i dukshëm në momentin e hapjes së web-site (portalit).
- Këto spote do të transmetohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së fushatës së komunikimit për një periudhë prej 3 muajsh.
- Video duhet të jenë në variantin edhe për personat me aftësi të kufizuar në shikim dhe dëgjim, pra të realizohet për tu kuptuar nga kjo kategori.
- Rritja çdo ditë e numrit të përdoruesve të internetit, përdorimi i internetit si mjet parësor informimi jo vetëm nga brezat e rinj, sjell avantazhet që media online ka, si shpejtësia në transmetimin e informacionit. Në këtë mënyrë impakti mbi audiencën do të jetë maksimal.
- Transmetimi i imazheve në web-site (portale) do të rrisë shikueshmërinë e tyre nga audienca e shënjestruar dhe do të ofrojë informacion të bollshëm në një mënyrë të shpejtë.

KËRKESA SPECIFIKE NË LIDHJE ME OFERTAT E PARAQITURA

- Dokumentacioni ligjor që duhet paraqitur si kriter kualifikues:**

Oferta duhet të paraqitet në terma ekonomik në Lekë, (pa dhe me TVSH).

Autoriteti Kontraktor nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet tej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Dokumentacioni përkatës i kërkuar do të jetë:

1. Vendimi për regjistrim në Gjykatë apo ekstrakt nga QKR.
2. Vërtetim nga Organet kompetente për likuidimin e detyrimeve fiskale, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel.+355 4 2226288, www.ama.gov.al

3. Vërtetim që subjekti nuk është në proces falimentimi.
4. Vërtetim që subjekti nuk është në proces penal lidhur me aktivitetin që ushtron.
5. Garanci bankare/shoqëri sigurimi 2% të vlerës së fondit limit.
6. Kopje të certifikuara të bilanceve, të paraqitura dhe konfirmuara në Autoritetet përkatëse për 2 vitet e fundit 2013 - 2014.
7. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për 2 vitet e fundit 2013 – 2014.
8. Operatorët ekonomik duhet të paraqesin projekt – ide për menyren e realizimit të spoteve.
9. Lista e web-site shqiptare më të shikuara me profil informativ.
10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që përmbush të gjitha specifikimet teknike dhe që ka kapacitetet e nevojshme njerëzore për realizimin e shërbimit të kërkuar sipas kritereve të përcaktuara.

Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr. 1195 datë 5.8.2008.

Dokumentacioni i sipërcituar duhet të jetë origjinal apo fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Kriteret e Vlerësimit:

Vlerësohet me 35 pikë Projekt - Ideja e realizimit të Spotit e cila përmban: Regjia, montazhi efektet + 3D Compositing, audio- video dhe staf ndihmues, etj).

Vlerësohet me 15 pikë dokumentacioni ligjor i paraqitur:

Vlerësohet me 50 pikë oferta më e ulët ekonomike e operatorit, bazuar në:

Çmimin më të ulët për prodhimin dhe publikimin e spotit

- i. Projekt - Ideja e realizimit të spotit 35
- ii. Dokumentacioni ligjor 15
- iii. Çmimin më të ulët për prodhimin dhe publikimin e spotit 50

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

Pe = 100 x Çu / Ç

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë

Pesha per Propozimin Artistik: Y = (piket e propozimit tekniko artistik x 0.35)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel.+355 4 2226288, www.ama.gov.al

Pesha per -: X = (piket e propozimit tekniko artistik x 0.15) /agjencitë e specializuara

Pesha per Propozimin Ekonomik: Z = (piket e propozimit ekonomik x 0.5)

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik.

Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = X + Y+Z

Dokumentacioni i sipërcituar duhet të jetë origjinal apo fotokopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Data përfundimtare e paraqitjes së ofertave:

20.07.2015, ora 12:00 në ambientet e Autoriteti Mediave Audiovizive.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni ofertën pranë Autoritetit tonë Kontraktor:

Emri: AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Përballë "Torre Drin", Tiranë
Tel/Fax: 04 2226288
Adresa e Internetit: www.ama.gov.al
Në emër të: Kryetarit Z. Gentian Sala
E-mail info@ama.gov.al

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në një zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën tuaj. Mbi zarf duhet të jetë shënuar ofertë për shërbimin sipas "Ftesë për Negociatë".

Ofertues apo përfaqësues të tyre janë të ftuar të ndjekin hapjen e ofertave.

Mbetemi në pritje të ofertës tuaj.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

K R Y E T A R
GENTIAN SALA